

REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJIGJEVE

JANAR – DHJETOR 2022

Nr. Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkeses	Tarifa
01.	21.12.2021	1- A ka banesa sociale aktualisht në qytetin Vaut te Dejes? Nëse po, sa është numri i tyre? 2- Sa ka qenë numri i aplikantëve për përfitimin e statusit të 'Pronarit Social'? 3- Sa prej aplikuesve e kanë përfituar statusin e 'Pronarit Social'?	06.01.2022	1. Në mungesë të banesave sociale është zhvilluar suvencioni i qerasë në tregun e lirë. 2. Numri i aplikantëve është 16, ndërsa numri i përfituesëve të bonusit të qerasë është 4. 3. Për përmirsim të banesave deri në ndërtim të plotë të tyre numri është 14, të përfunduara janë 7 dhe në proces rikonstruksioni janë 7.	E plotë	Pa pagesë
02.	18.01.2022	1. A keni të dhëna se sa familje janë të pastreha në vend dhe kanë kërkuar ndihmë nga shteti shqiptar? 2. A janë strehuar nëpërmjet formave që parashikon ligji këto familje? 3. Në rastet kur familjet në nevojë nuk i plotësojnë kushtet për të marrë kredi të zbutur, si procedohet, si ndihmohen? 4. Gjatë këtij procesi a ka abuzime nga persona që janë në gjendje të mirë ekonomike?	24.01.2022	1. Jo nuk kemi. 2. Cdo familje që merr shërbim mbi programet e strehimit, shërbimin e merr në bazë të ligjit. 3. Qëndrojnë në listë pritje për marrjen e ndonjë shërbimi tjetër nga programet. 4. Cdo trajtim me programe strehimi jepet sipas kategorive prioritare sipas ligjit.	E plotë	Pa pagesë

		5.Keni ju si institucion sugjerime për ndryshime në procedura për të përfituar nevojtarët dhe kufizuar abuzimet? 6. Cilat bashki apo qytete kanë më shumë persona të pastrehë?		5.Kuadri ligjore është shume i mirë dhe nuk kemi sugjerime. 6.Nuk kemi informacion .		
03.	30.06.2022	1.Listen emërore të punonjesve në pozicione drejtuese të larguar për shkak të Dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022 2. Listen emërore të punonjesve në pozicione drejtuese që janë në process hetimor për shkak të Dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022. 3. Listen emërore të punonjesve në pozicione drejtuese që janë dënuar për shkak të Dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022. 4. Listen emërore të punonjesve në pozicione drejtuese që kanë refuzuar plotësimin e formularit të Dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022 5.Listën emërore të këshilltarëve bashkiakë që kanë refuzuar plotësimin e formularit të Dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri më Qershor 2022.	04.07.2022	1.Punonjësit në pozicione drejtuese të larguar për shkak të Dekriminalizimit për periudhën tetor 2019 – qershor 2022 është nje punonjës me pozicion Përgjegjës i Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda” Bushat. 2.Punonjës në pozicione drejtuese që janë në proces hetimor për shkak të Dekriminalizimit për periudhën tetor 2019 – qershor 2022 nuk kemi. 3.Punonjës në pozicione drejtuese që janë dënuar për shkak të Dekriminalizimit për periudhën tetor 2019- qershor 2022 nuk kemi. 4.Punonjës në pozicione drejtuese që kanë refuzuar plotësimin e formularit të Dekriminalizimit për periudhën tetor 2019- qeshor 2022 nuk kemi. 5.Këshilltarë bashkiakë që kane refuzuar plotësimin e formularit të Dekriminalizimit dhe/ose që janë larguar për periudhen tetor 2019 –	E plotë	Pa pagesë

4.	25.07.2022	1.A ka bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grupmoshën 15-29 vjec)? Nëse po,sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet se përse nuk ka një planifikim të tillë? 2.A ka të punësuar pranë Bashkisë suaj individë të moshës 18-29 vjec (përfshirë drejtuesit)? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 3.Sa është përqindja e të rinjve (18-29 vjec) të punësuar krahasuar me numrin total të administrates? 4.A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën 15-29 vjec? Nëse po a mund të na l dërgoni një kopje të tyre? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë? 5.A keni në institucionin tuaj struktura përgjegjëse të politikat rinore? Nëse po, cilat janë ato (psh. Drejtori, sektoret, specialistet, struktura përfaqësimi rinor politikë etj) dhe prej sa kohësh janë funksionale? 6.A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar-dhjetor 2021. Nëse po, cilat janë ato?	05.08.2022	qershor 2022 nuk kemi. 1.Po, Bashkia Vau Dejes për vitin 2022 ka planifikuar fond për rininë (grup moshën 15 deri 29 vjeç) , në masën 3.88 % ndaj buxhetit total. 2. Në bashkinë tonë ka të punësuar individë të kësaj grup moshe. Gjithësej jane 63 persona , nga të cilët 25 prej tyre janë femra dhe 38 janë meshkuj. 3. Në krahasim me numrin total të të punësuarve në administratë 17.6 % është përqindja e të rinjë të punësuar të kësaj grup moshe. 4. Për sa i përket Politikave Rinore ju informojmë se akoma nuk është ndërtuar një strukturë e mirëfilltë përgjegjëse për të ndjekur politikat Rinore në Bashkinë Vau Dejës.	E plotë	Pa pagesë
----	------------	---	------------	---	---------	-----------

		7.Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore,grupe rinjsh, individë,etj). 8.A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimi (me grupe të rinjsh, organizata rinore , etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konstatuar ato? 9.Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia nërfshirjen e të rinjve në të tilla procese?		9. Ju bëjmë me dije se në konsultimet publike që zhvillohen nga ana jonë, marrin pjesë aktive rreth 40 % të rinj por kjo është relative. Ne përdorim për tu bërë pjesë rinia në konsultime, njoftimet në vende publike, rrjetet sociale, WEB-in e Bashkisë, takimet e përditshme etj.		
5.	29.08.2022	1.Të dhëna teknike mbi landfillin në bashkinë tuaj dhe sa është kapaciteti i depozitimit për të cilin është ndërtuar ky landfill?	08.09.2022	1. Në rajonin e Shkodrës1 , Vend depozitimi sanitar i Bushatit u ndërtua brenda një sipërfaqeje toke të rrethuar prej 23 ha dhe u projektua për një kapacitet prej 1 milion tonë mbetje që do të grumbulloheshin nga qarqet e Shkodrës dhe Lezhës.41 Nisi nga puna në Korrik 2011. Ky impiant përfshin disa aktivitete si: një peshore, një impiant për ndarjen e mbetjeve (nuk ishte funksional në Mars 2017), sisteme për trajtimin e lëngut kullues dhe të ujërave sipërfaqësore (jo funksional), sistem për mbledhjen e gazit (nuk funksionon mirë) dhe mjete pune të rënda (kompaktor, buldozer) dhe menaxhohet nga një kompani aksionare, në pronësi të njëres prej bashkive pjesëmarrëse (Ndërkomunale Bushat)42. Për shkak të disa marrëveshjeve mbi tarifat e vend depozitimit, sasitë e mbetjeve që janë çuar faktikisht janë shumë më të ulëta se sasitë e planifikuara dhe për pasojë kostot operative për njësi të vend depozitimit janë rritur. Aktualisht puna në vend depozitim përmban vetëm shtyrjen, sheshimin dhe deri diku mbulimin me dhë të mbetjeve. Për shkak të distancave të mëdha të udhëtimit të kamionëve të	E plotë	Pa pagesë

		2.Sa është vlera e kontratës së lidhur për ndërtimin e të gjithë projektit? 3.Sa është vlera e shpenzuar vetëm për ndërtimin e landfillit nga vlera totale e kontratës? 4.Nje kopje e kontratës së lidhur me fituesin e tenderit për këtë project. 5.Cilat janë kostot e bashkisë për ton mbetje të depozituara në këtë landfill?	grumbullimit, është propozuar ndërtimi i stacioneve të transferimit për të bërë më efektiv nga pikëpamja e koston transferimin e mbetjeve për në vend depozitimin rajonal (mbështetur nga DLDP e financuar me fonde zvicerane). 2.Lidhur me këtë pyetje, përgjigja e saj varet thelbësisht më kohën për të cilën ju i referoheni pasi investimi i tërë është i ndarë në dy faza. Faza e Parë i përket vitit 2008 dhe Faza e Dytë është parashikuar në Planin Kombëtar Sektorial Per Menaxhimin E Mbetjeve Te Ngurta Investimet në landfill janë të një natyre dinamike pasi vetë aktiviteti që ushtrohet është i tillë. Në Planin Kombëtar Sektorial Per Menaxhimin E Mbetjeve Te Ngurta paraqiten këto të dhëna : “Është kërkuar financim nga MIE në sasinë 1.8 milion Euro për ndërtimin e fazës së dytë të vend depozitimit përfshirë qelizat e reja të vend depozitimit... Kërkesa për financim në total për vend depozitimin e Bushatit për fazën 1 është llogaritur me 3.5 milion Euro” 3-4.Në pytjet që keni shtruar ju kërkojmë të jeni më specifike lidhur me natyrën e informacionit që kërkonit pasi termat që përdorni si psh'i gjithë projekti' dhe 'landfilli' në këtë pyetje përdoren si koncepte ndaras ndërsa në kërkesën për informacion i referoheni të njëjtit koncept. Sidoqoftë, projekti për të cilin bëhet fjalë quhet Landfilli i Bushatit dhe si i tillë nuk mund të konceptohet i ndarë nga projekti pasi Landfilli është vetë projekti. Megjithatë dokumentat që ju kërkonit janë të vitit 2006 dhe referuar ligjit Nr. 9154 “Për Arkivat” neni43, pika ‘a’ “dokumentet administrative dorëzohen pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit të tyre”. 5.Bazuar në pytjen tuaj nuk e kuptojmë nëse i referoheni Bashkisë Vau Dejës apo bashkive të tjera, megjithatë për bashkitë që kanë lidhur kontratë për depozitimin e mbetjeve ju paraqesim koston: Cmimi për depozitimin e mbetjeve urbane është: 1500 lekë pa TVSH.	
--	--	---	--	--

		6.Cilat janë bashkitë që depozitojnë mbetjet pranë këtij landfilli? 7.Aktualisht sa ton mbetje mund të depozitohen në landfill duke llogaritur depozitimet e bëra deri më tani, përafërsisht me sa kohë korrespondon kjo sasi e mbetur, pra dhe sa kohë do mund të përdoret ky landfill?		6. Shoqëria 'Ndërkomunale Bushat sh.a' ka lidhur kontratë me operatorët që ofrojnë shërbimin e pastrimit me Bashkitë si: Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Lezhë dhe Kurbin. 7. Në rast se do të realizohen investimet e parashikuara edhe në Planin Kombëtar Sektorial Per Menaxhimin E Mbetjeve Te Ngurta ku parashikohen edhe investime të nevojshme për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e këtij landfilli mundet që një aktivitet i tillë të vazhdojë për më shumë se 20 vjet dhe me një kapacitet depozitimi përafërsisht deri në 2 milion Ton mbetje.		
6.	14.09.2022	1.Sa është numri i punëmarrësve të cilët kanë përfunduar marrdhënien e punës për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e Insitucionit tuaj për periudhën 2017-2022 ? ” 2.Sa prej tyre i janë drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës?”	23.09.2022	1. Numri i punëmarrësve të cilët kanë përfunduar marrdhënien e punës për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës rezulton të jetë sipas informacionit të marrë në Sektorin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore rreth 142 punëmarrës. 2. Vetëm 23 raste i janë drejtuar gjykatës për mosmarrëveshjet e lindura për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës.	E plote	Pa pagesë

		3.Çfarë vendimi ka marrë Gjykata për rastet konkrete? 4. Ju lutem, na vendosni në dispozicion kopje të vendimeve gjyqësore. 5. A ka patur raste ku punëmarrësve iu është ofruar zgjidhja e konfliktit nëpërmjet ndërmjetësimit? Nëse po, sa raste janë zgjidhur nëpërmjet kësaj procedure? 6. Sa është vlera e dëmshpërblimit që është akorduar punëmarrësit/gjyqfitues nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore?		3.Për disa nga rastet e mësipërme janë marrë vendime të formës së prere, për 3 ish-punonjesit. Ndërsa të tjerat aktualisht janë në gjykim e sipër. 4.Po ju dërgojmë bashkëlidhur kopjet e vendimeve të mësipërme. 5. Po në të shumtën e rasteve punëmarrësve iu është ofruar zgjidhja e konfliktit me ndërmjetësim, dhe vetëm disa raste është pranuar kjo procedurë ndërmjetësimi. 6. Janë ekzekutuar katër vendime gjyqësore, nëpërmjet porcedurave përmbartimore. Konkretisht vlera në total e dëmshpërblimit është: Për Vitin është 2018 1,211,923.00 Lekë Për Vitin është 2021 639,100.00 Lekë Për Vitin është 2022 2,404,342.00 Lekë.		
7.	10.10.2022	1.Ju lutemi na vendosni në dispozicion buxhetet e institucionit tuaj në 5 vitet e fundit.	21.10.2022	1.Për informacion të përgjithshëm lidhur me buxhetin mund të referoheni tek faqja online e Bashkisë Vau Dejës, ku aty ju mund të përzgjidhni informacionin që kërkonit dhe klikoni për ta hapur. https://www.vaudejes.gov.al/buxheti/	E plotë	Pa pagesë

		2.Ju lutemi na vendosni në dispozicion detyrimet e prapambetura të insitucionit tuaj dhe ndaj kujt janë, si një zë i veçantë për secilin prej tyre. 3.Ju lutem na vendosni në dispozicion tenderat e kryer prej insitucionit tuaj gjatë 3 viteve të fundit. 4.Ju lutem na vendosni në dispozicion numrin e punonjësve në total dhe të ndarë sipas drejtorive dhe institucioneve në varësi të Bashkisë. 5.Ju lutem na vendosni në dispozicion një listë të financimeve të tre viteve të fundit ku bashkia juaj ka qenë përfituese.		2.Ju bëjmë me dije se informacioni i kërkuar, i nënshtrohet kufizimeve të nenit 17, pika 1 gërma 'b' Ligjit 119/2014 dhe kalsifikohet si 'sekret tregtar'. 3.Faqja e Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim APP) ju vjen në ndihmë për të kërkuar nëpërmjet aplikimit të filtrave sipas kategorive të procedurave të prokurimit publik të cilat shpallen në Këndin Online të njoftimit të faqes. Nëse vendosni të kërkonti me filtra Autoriteti/Enti Kontraktor është Bashkia Vau Dejës. Kërkime të mëtejshme mund të bëni edhe në Buletinin Publik sipas Vitit Përkatës që ju kërkonti informacionin. https://www.app.gov.al/ 4.Për këtë kërkesë ju mund t'i drejtoheni online faqes së Bashkisë Vau Dejës ku gjeni të pasqyruar të dhënat lidhur me Organogramën sipas viteve të ndryshme si dhe me numrin e punonjësve të sektorëve të ndryshëm. Më poshtë gjeni linkun për të naviguar më detajisht. https://www.vaudejes.gov.al/struktura-e-pagave-2/ 5.Financimet janë pjesë e paketës fiskale të Bashkisë Vau Dejës të cilat i gjeni të publikuara online. https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Buxheti-PBA-2022-2024_compressed-2.pdf	
--	--	---	--	---	--

		6.Ju lutem na vendosni në dispozicion numrin e punonjësve të ndërrmarjeve të pastrimit. Nëse është subjekt privat që e ofron këtë shërbim ju lutem na vendosni në dispozicion kontratat e lidhura gjatë 3 viteteve të fundit me to.		6.Duke qënë se kjo kërkesë lidhet me një kontratë mes Bashksië Vau Dejës dhe një Operatori Ekonomik, kontratë e cila ka të parashikuar kushtet dhe specifikat e saj por aktualisht është objekt administruar nga Prokuroria Speciale për Hetimin dhe luftën ndaj Korrupsionit (SPAK), informacioni i dhënë për këtë rast është pranë kësaj Prokurorie në kuadër të mabrëvjatjes së hetimit.	
		7.Ju lutem na vendosni në dispozicion se ku depozitohet/asgjesohen mbetjet në bashkinë tuaj si dhe metodën e përdorur për asgjesimin e tyre.		7/8. Ju informojmë se Bashkia Vau Dejës ka zgjidhur problemin e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe përdor kështu Landfillin e Bushatit i cili ka një sipërfaqe të konsiderueshme dhe një kapacitet i cili e përballon menaxhimin e mbetjeve urbane referuar kontratave të cilat ka lidhur me Bashkitë përkatëse. Cmimi për depozitim të mbetjeve urbane është: 1500 lekë pa TVSH. Kapaciteti i mbetjeve për ton që depozitohet varjon mesatarisht nga 300 ton- 500 ton/ muaj. https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/PLANI-KOMBETAR-SEKTORIAL-PER-MENAXHIMIN-E-MBETJEVE-TE-NGURTA.pdf	
		8.Nëse këto mbetje transportohen në një landfild ju lutem na vendosni në dispozicion sa është pagesa për një ton dhe sa ton mbetje në ditë grumbullohen në bashkinë tuaj.			
		9.Ju lutem na vendosni në dispozicion sa % e buxhetit bashkiak shkon për mirmbajtjen e shkollave 9- vjeçare dhe të mesme si dhe shërbimeve të tjera që ofrohen për to. Gjithashtu na e vendosni në dispozicion edhe si shifër monetare.		9.Në mënyrë që të keni një pasqyrim më të saktë po ju referojmë te Buxheti i Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr 72 datë 23.12.2021 me anë të të cilit mund të shihni shpërndrjen e zërave të buxhetit sipas përqindjes.	

		10.Sa orë në ditë bashkia juaj ka furnizim me ujë të pijshëm? 11.Sa është çmimi i ujit në bashkinë tuaj?	https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Buxheti-PBA-2022-2024_compressed-2.pdf 10. Referuar kësaj kërkesë ju informojmë se politikat e Bashkisë Vau Dejës në bashkëpunim me shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sha synojnë të arrijnë maksimumin e ofrimit të shërbimit në mënyrë sa më optimale dhe të thjeshtë për konsumatorët, jo vetëm për nga cilësia e ujit, por në mënyrë më domethënëse të arrijmë të krijojmë dhe mirëmbajmë një rrjet sa më funksional për të gjithë përdoruesit e ujit. Konkretisht në kuadrin e investimeve të kryera deri më tani flasim për një furnizim me orar 12 orë në fshat dhe 24 orë në qytet. Megjithatë kjo nuk na pengon që ne si Bashki me investimet e planifikuara të gjejmë mënyra të tjera për të arritur në standardet maksimale të furnizimit dhe cilësisë së ujit. 11.Cmimi i ujit në Bashkinë Vau Dejës, por edhe në bashkitë e tjera rregullohet nga Enti Rregullator i Ujit. ERRU është institucion publik i pavarur që bën rregullimin e sektorit ujësjetllës kanalizime në Shqipëri, i krijuar me ligjin 8102 dt. 28.03.1996, i ndryshuar, për të siguruar garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike dhe për të krijuar një mjedis rregullator transparent. Cmimi të cilit I referohemi është 42 lekë për m³ (metër kub).	
--	--	--	--	--

		12.Çfarë taksash ngarkon mbi qytetarët institucioni juaj?		12.Taksat dhe tarifat e miratuara që aplikohen nga Bashkia Vau Dejës janë të kategorive të ndryshme të cilat mund ti gjeni të pasqyruara në Buxhetin e vitit 2022, si psh marrim taksën për biznesin e madh dhe të vogël, taksa për pasurinë e paluajshme, etj. https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Buxheti-PBA-2022-2024_compressed-2.pdf		
		13.Sa është sipërfaqeja e gjelbër në Bashkinë tuaj?		13. Referuar kësaj kërkesë më poshtë ju paraqesim një tabelë ku gjeni të pasqyruar të dhënat e kërkuara.		
		14.Ju lutem na vendosni në dispozicion, sa % e buxhetit shkon për gjelbërimin, dhe gjithashtu na e vendosni në dispozicion si shifër monetare për tre vitet e fundit.		14. Po ashtu këto të dhëna mund t'i gjeni të pasqyruara në Buxhetin e Vitit 2022. https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Buxheti-PBA-2022-2024_compressed-2.pdf		
		15.Ju lutem na vendosni në dispozicion listën me të gjitha blerjet e pemëve për gjelbërimin e qytetit, çmimin për njësi të tyre si dhe zonat dhe kohën kur janë mbjellur.		15. Lidhur me këtë pyetje ju bëjme me dije se nuk kemi pas blerje të pemëve për gjelbërimin e qytetit por kemi nje plan menaxhimi pyjesh të cilin e kemi shpallur dhe është në procedurë e sipër. Për më tepër ju mund t'i drejtoheni online faqes të APP.		

		16.A ka bibliotekë në bashkinë tuaj? Nëse po, sa është investimi vjetor I bashkisë në këtë bibliotekë dhe ku ka konsistuar ky investim gjatë 3 viteve të fundit? 17.Sa monumente kulture që janë përgjigjësi e Bashkisë tuaj janë në Bashkinë tuaj? 18.Ju lutem na vendosni në dispozicion investimet e kryera nga institucioni juaj për Monumentet e Kulturës gjatë tre viteve të fundit si dhe të ardhurat prej tyre për tre vitet e fundit. 19.Sa janë të ardhurat e arkëtuara në Bashkinë tuaj prej “Taksës së qytetit” nga institucionet e hotelierisë dhe akomodimit për tre vitet e fundit. Ju lutem na i vendosni në dispozicion të ndara për secilin vit. 20.Ju lutem na vendosni në dispozicion tenderat e zhvilluara për nevojat e brendshme të institucionit tuaj (si p.sh. Blerje uji, blerje mobiljesh, pasije teknologjike etj) gjate tre viteve të fundit.	16. Në Bashkinë Vau Dejës nuk ka bibliotekë. 17. Referuar monumenteve kulturore sipas kuptimit të ligjit 27/2018 “Për trashigiminë kulturore dhe muzetë” në Bashkia Vau Dejës monumentet e kulturës janë në pronësi shtet por që administrohen edhe nga Bashkia Vau Dejes. 18. Nga monumentet e kultures që ndodhen në territorin e Bashkisë Vau Dejes nuk gjenerohen të ardhura pasi janë të aksesueshme pa pagesë. 19. Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë si më poshtë mbi të ardhurat sipas viteve: Viti 2020 --- 74655 lekë Viti 2021 --- 57575 lekë Përsa i përket vitit 2022 mbi të ardhurat nuk mund të japim nje shifër pasi akoma nuk ka mbaruar viti. 20. Lidhur me këtë kërkesë ju informojmë se për nevojat e brendshme të institucionit tonë janë periodike, procedura të cilat po ashtu mund t'i gjeni në faqen zyrtare të APP , ndërsa për blerje uji nuk kemi zhvilluar asnjë procedurë.	
--	--	---	---	--

